

URDHËR
Nr. 119/1, datë 18.9.2024

**PËR PËRFUNDIMIN E DELEGIMIT TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCËS
PËR MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE TË AGJENCISË SË
MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA**

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të ligjit nr. 8417/1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të urdhrit nr. 184, datë 17.9.2024, të Kryeministrit “Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera”,

URDHËROJ:

1. Përfundimin e delegimit të kompetencës për mbikëqyrjen e veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, të z. Besmir Beja.
 2. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Drejtoria e Mirëadministrimit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, në Ministrinë e Financave, për komunikimin e këtij urdhri, si dhe z. Besmir Beja dhe Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera për zbatimin e tij.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCVE
Petrit Malaj